



Zyra e Kryetarit të Komunës
Nr. 02/Zyrtarisht
Datë: 27 korrik 2026

Bazuar në nenin 42, paragrafi 2, pika 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe nenin 12, paragrafi 5, pika 5.3, paragrafi 8, të Rregullores (QRK) Nr. 07/2025 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, Komuna e Deçanit me datë: 27.07.2026, shpall këtë:

SHPLLJE PUBLIKE

(Për profesor të fushës-zëvendësues)

Titulli i vendit të punës: Profesor i fushës së njëjtë për pozitën për të cilën zhvillohet konkurrimi, organizata të specializuara apo universitetet.

Vendi i Punës: Komuna e Deçanit

Pagesa fikse është 250 euro e cila paguhet për secilën procedurë të rekrutimit kategoria funksionale Specialist/e.

Mandati i ekspertit është: dy (2) vjeçar.

Detyra e ekspertit është: Vlerësimi profesional i kandidatëve për pranim Nëpunësja/i i shërbimit civil, për kategorinë e specialistes/it.

Kriteret dhe dokumentet qe duhet bashkëngjitur me aplikacion:

- Diplomë universitare me të paktën 240 kredi -për edukimin e marr jashtë vendit duhet të bëhet nostrifikimi i diplomës;
- Të ketë përvojë pune të paktën katër (4) vite në Universitet apo organizata të specializuara;
- Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Të kenë integritet moral dhe profesional;
- Të mos jetë i punësuar në Shërbimin Civil, të mos jetë i larguar nga Shërbimi Civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e diplomës të noterizuar;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dëshmi që nuk është i dënuar penalisht për kryerjen e ndonjë veprë penale;
- Deklaratë se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pese (5) vitet e fundit;
- Deklaratë se nuk është i punësuar në Shërbimin Civil, të mos jetë i larguar nga Shërbimi Civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Formulari i aplikimit merret në Zyrën Pritëse kati përdhese dhe dorëzohet në Zyrën Pritëse, nga ora: 08:00^h-16:00^h në objektin e komunës së Deçanit, formularët mund të merren edhe në linkun e ueb faqes komunale: <https://konkursi.rks-gov.net/> .

Afati për paraqitjen e aplikacioneve është 8 (tetë) ditë nga data: 28/07/2026 deri 04/08/2026.

Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim. Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret hyjnë në listën e ngushtë dhe njoftohen përmes tabelës së shpalljeve publike dhe telefonit.

		KOMUNA E DEÇANIT MUNICIPALITY OF DEÇAN REPUBLIC OF KOSOVA	
Nr. aplikimi	Z. FRYEDARIS		15111
Dorëzuar në			
Nr. aplikimi	02	27.07.26	
Re. aplikimi			
Nr. aplikimi			



Kryetari i komunës:


Bashkim RAMOSAJ